



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Maliq, më 25.01.2023

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, “Funksionimi i këshillit bashkiak”, pika 2, pika 4, 5 neni 56 “Kryetari i këshillit bashkiak” pika 2 gërma “a”, dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq” ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet fizikisht në sallën e këshillit ditën e **martë, më datë 31.01.2023, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19.12.2022;
3. Miratimin e raportit hartuar nga Komisioni i Mandateve, pranë Këshillit Bashkiak “Mbi heqjen e mandatit të këshilltarit z. *Llambi Vasil Kotmilloshi*” pas heqjes dorë nga mandati i këshilltarit.
4. P-V “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionin për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor”;
5. P-V “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionin për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në masën 6%.
6. P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2022”;
7. P-V “Për caktimin e vlerës së përfituesëve të qirasë për vitin 2023 për familjet të cilat janë strehuar në banesën sociale”;
8. P-V “Për miratimin e listës së përfituesëve nga programi “Subvencioni i interesave të kredive”;
9. P-V “Për miratimin në parim të projektit “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2023”;
10. P-V “Për miratimin e bursave të arsimit profesional të vitit shkollor 2022-2023”;
11. P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr.105 datë 19.12.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe struktura të tjera për vitin 2023”;
12. P-V “P-V “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2023-2026”;
13. P-V “Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2023 të Bashkisë Maliq”;
14. P-V “Për dhënie tituj nderi”;
15. Diskutime të tjera.

Ju faleminderit!

**KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI**